



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 22 mars 2021
Nr.ref.:RK1733/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI104/20

Parashtrues

Ejup Koci

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së procedurave në Gjykatën Themelore në
Mitorivcë – Dega në Skenderaj, përkitazi me lëndën C.nr. 256/2018**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gerxhaliu-Krasniqi, gjyqtare,
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar,
Radomir Laban, gjyqtar,
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Ejup Koci (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), me vendbanim në Skenderaj.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk e konteston ndonjë akt konkret të autoriteteve publike. Ai konteston kohëzgjatjen e procedurës përkitazi me gjykimin e lëndës C. nr. 256/2018, që është duke u zhvilluar në Gjykatën Themelore në Mitrovicë - Dega në Skenderaj (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës përkitazi me gjykimin e lëndës C.nr. 256/2018.

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] e 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 30 qershor 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
6. Më 27 gusht 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një dokument shtesë.
7. Më 6 korrik 2020, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetarja caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërzhaliu Krasniqi.
8. Më 21 korrik 2020, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Themelore.
9. Më 1 tetor 2020, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë disa dokumente shtesë.
10. Më 10 shkurt 2021, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Parashtruesi parashtron kërkesë për herë të katërt në Gjykatë.
12. Në lidhje me kërkesën e parë, me 8 shtator 2017, parashtruesi i kërkesës parashtrroi kërkesën KI109/17 në Gjykatë, nëpërmjet të cilës kontestoi tejzgjatjen e procedurave, përkatësisht zvarritjen e procedurës për vendosje në lëndën civile [C. nr. 0355/2011], e cila kishte të bënte me shpronësimin e

paluajtshmerive për shkak të ndërtimit të rrugës ndër-komunale Skenderaj - Vushtrri. Parashtruesi, në atë rast pretendonte se gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenet: 22 [Zbatimi i drejtpërdrejt i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], 23 [Dinjiteti i Njeriut] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, si dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor], në lidhje me nenin 13 [E drejta për zgjidhje efektive] të KEDNJ-se. Me 30 maj 2018, Gjykata nxori Aktvendim për papranueshmëri nr. KI109/17, me të cilin konkludoi se parashtruesi i kërkesës nuk dëshmoi në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij për shkeljen e të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (gjegjësisht të drejtën në gjykim të drejtë, brenda një afati kohor të arsyeshëm).

13. Në lidhje me kërkesën e dytë, me 22 tetor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën nr. KI161/18 në Gjykatë, nëpërmjet të cilës kontestoi Aktvendimin [Rev. Nr. 105/2018] të Gjykatës Supreme me pretendimin se nuk i është respektuar e drejta për qasje në gjykatë, ngase Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme nuk morën parasysh provat e parashtruara nga ai. Parashtruesi në atë rast, pretendonte se gjykatat e rregullta shkelën të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenet: 31 [E drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshme], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 46 [Mbrojtja e Pronës], 54 [Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave], 55 [Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore], të Kushtetutës, si dhe nenin 6 [E drejta për një proces të rregullt gjyqësor] dhe nenin 1 të Protokollit nr. 1, të KEDNJ-se. Me 23 korrik 2019, Gjykata shpalli kërkesën të papranueshme pasi që kërkesa nuk ishte dorëzuar brenda afatit ligjor.
14. Në lidhje me kërkesën e tretë, më 17 prill 2019, parashtruesi i kërkesës dorëzoi kërkesën nr. KI64/19, nëpërmjet të cilës kontestoi Aktvendimin [Cnr. 204/2015] të Gjykatës Themelore. Më 26 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesën për tërheqjen e kërkesës nr. KI64/19. Gjykata, në këtë rast, duke iu referuar edhe praktikës se saj gjyqësore, vlerësoi se nuk ka ndonjë arsye bindëse për vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës për vlerësimin e kushtetutshmërisë të Aktvendimit të kontestuar, përkundër kërkesës së parashtruesit për tërheqjen e kërkesës së tij. Më 25 shtator 2019, Gjykata miratoi kërkesën për tërheqjen e kërkesës nr. KI64/19.

Faktet e rastit në lidhje me kërkesën e tanishme KI104/20

15. Nga dokumentet e përfshira në kërkesë, rezulton se më 7 korrik 2015, parashtruesi i kërkesës ka ushtruar padi në Gjykatën Themelore për vërtetim të kufirit (mezhdës) të palujtshmerisë dhe vërtetim të pronësisë si pjesë e uzurpuar.
16. Më 17 janar 2017, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [Cnr. 204/2015] ia ktheu padinë parashtruesit të kërkesës për plotësim dhe saktësim.
17. Më 27 janar 2017, parashtruesi i kërkesës iu përgjigj kërkesës së Gjykatës Themelore për plotësim të padisë.

18. Më 12 prill 2017, parashtruesi i kërkesës dorëzoi një dokument shtesë në Gjykatën Themelore dhe kërkoi përshpejtim të procedurës së shqyrtimit të rastit të tij.
19. Më 27 prill 2017, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [Cnr.204/2015] ndërpreu procedurën kontestimore të parashtruesit të kërkesës dhe e udhëzoi këtë të fundit që të filloj procedurën për shqyrtimin e trashigimisë sepse në pronën e kontestuar, përveç parashtruesit të kërkesës kishte edhe pronarë të tjerë. Ndër të tjera, Gjykata Themelore theksoi se pasi të dihen pronarët në pronën e kontestuar mund të fillohet me procedura gjyqësore sipas rregullave të procedurës kontestimore.
20. Më 17 maj 2018, parashtruesi i kërkesës iu drejtua Gjykatës Themelore që të rifillonte procedura e ndërprerë përmes Aktvendimit [Cnr. 204/2015] të 27 prillit 2017, me arsyetimin se Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [Tc.nr.33/18] të 27 prillit 2018 kishte shpallur trashigimtarët në pronën e kontestuar.
21. Më 17 maj 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatën Themelore një dokument shtesë dhe kërkoi rifillimin e procedurës së ndërprerë, kërkesë të cilën e kishte ripërsëritur disa herë dhe atë me: 4 qershor 2018; 14 gusht 2018; dhe me 7 shkurt 2019,
22. Më 25 shkurt 2019, Gjykata Themelore njoftoi parashtruesin e kërkesës se rasti [C.nr.204/2015] është në procedurë dhe se më tutje identifikohet me shifrën e re [C.nr. 256/2018].
23. Më 4 prill 2019, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykatë Themelore që të shqyrtojë rastin e tij [C.nr.256/2018].
24. Më 21 qershor 2019, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykatë Themelore që të shqyrtojë rastin e tij [C.nr.256/2018].
25. Më 9 korrik 2019, Gjykata Themelore në afat prej 15 ditësh kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që të sjell adresën e saktë për palën kundërshtare H.K., në mënyrë që të i dërgohet ftesa për seancën e radhës.
26. Më 15 korrik 2019, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Themelore që t'ia lëshoj certifikatën gjyqësore në mënyrë që të marr adresën e saktë të palës kundërshtare H.K.
27. Më 29 tetor 2019, parashtruesi i kërkesës kërkoi nga Gjykata Themelore që ta informoi lidhur me statusin aktual të rastit të tij.
28. Më 11 nëntor 2019, parashtruesi i kërkesës kërkoi përsëri nga Gjykata Themelore që ta informoi lidhur me statusin aktual të rastit të tij.
29. Më 23 janar 2020, Gjykata Themelore e njoftoi parashtruesin e kërkesës së rasti i tij është duke u shqyrtuar me prioritet dhe se së shpejti do të caktohet edhe seanca.

30. Më 4 shkurt 2020, Gjykata Themelore nxori aktvendim përmes të cilit kërkoi nga parashtruesi i kërkesës që ta precizojë/plotësojë padinë në kuptimin subjektiv dhe vendosi që pala kundërshtare H.K., të ftohet në seancën e radhës.
31. Më 6 mars 2020, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën Themelore për tejzgjatjen e shqyrtimit të rastit të tij dhe kërkoi përjashtimin e gjyqtarit mbikëqyrës në rastin e tij.
32. Më 22 qershor 2020, Gjykata Themelore ftoi parashtruesin e kërkesës që të paraqitet në Gjykatën Themelore dhe të paguaj taksën gjyqësore në vlerë prej 20 euro, në emër të kërkesës për përjashtimin e gjyqtarit. Gjithashtu, Gjykata Themelore njoftoi parashtruesin e kërkesës se në rast të mos pagesës së taksës gjyqësore do të konsiderohet se është hequr dorë nga kërkesa e paraqitur.
33. Më 28 shtator 2020, Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [C.nr. 256/2018] vendosi që parashtruesin e kërkesës ta liroj nga taksa gjyqësore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

34. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *“Për shkak se me mosveprimet-veprimet e GJTHM- dega në Skenderaj me është pamundesuar qasja në Gjykatë e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Konventat Ndërkombëtare. Më është pamundesua barazia para ligji (neni 3.2 i KRK-ës). Më është pamundesuar mbrojtja e Pronës (neni 46), gjykimi në afat te arsyeshem, trajtim ndryshe nga të tjerët- diskriminim (neni 24), mos respektim i të drejtave njerëzore n(eni 21.3 i Kushtetutës).”*
35. Parashtruesi i kërkesës, kërkon nga Gjykata që të *“[...] kërkoi nga Gjykata Kushtetuese që të nxjerr aktgjykim me të cili do të konstatoi se ka shkelje të drejtave njerëzore si: - e drejta për qasje në gjykata, për mbrojtje ligjore të pronës, gjykim të drejtë e të pa anëshem, mbrojtjen gjyqësore të drejtave (neni 54) gjykim në afat të arsyeshem, ndalim i diskriminimit (trajtimi ndryshe nga të tjerët)”*

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

36. Gjykata fillimisht shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të specifikuara më tej me Rregullore të punës.
37. Gjykata iu referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“(1) Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

(7) Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë,

mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

38. Gjykata gjithashtu i referohet kriterëve të pranueshmërisë, siç parashikohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale], që parasheh:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individit mund ta ngrit kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

(...)”.

39. Përveç kësaj, Gjykata shqyrton nëse parashtuesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton kriteret në bazë të se cilave Gjykata mund të shqyrtojë kërkesën, duke përfshirë kriterin që kërkesa të mos jete qartazi e pabazuar. Specifikisht, rregulli 39 (2) përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën te papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtuesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.

40. Gjykata vëren se parashtuesi i kërkesës pretendon se lënda e tij po zvarritet nga Gjykata Themelore. Në thelb, parashtuesi i kërkesës pretendon shkelje kushtetuese si rezultat i mosveprimit dhe kohëzgjatjes së procedurave lidhur me shqyrtimin e rastit të tij nga ana e Gjykatës Themelore.
41. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet nenit 31 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNJ-së:

*Neni 31.2 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]
i Kushtetutës*

“[...]

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet [...] brenda një afati të arsyeshëm [...]”.

Neni 6.1 (E drejta për gjykim të drejtë) i KEDNJ-së

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm ...”.

42. Për të verifikuar bazueshmërinë e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës në lidhje me shkeljet e të drejtave dhe lirive kushtetuese që kanë të bëjnë me marrjen e vendimeve brenda një kohe të arsyeshme, Gjykata do të merret me: i) vërtetimin e periudhës së kohëzgjatjes të procedurës në tërësi në institucionet kompetente, ii) parimet relevante në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave, dhe iii) arsyeshmërinë e kohëzgjatjes së procedurave para Gjykatës Themelore.

i) Periudha që do të merret parasysh

43. Në rastin konkret, Gjykata vëren se në korrik 2017, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur padinë në Gjykatën Themelore për vërtetim të kufirit (mezhdës) të palujtshmerisë, dhe vërtetimin e të drejtës së pronësisë në lidhje me ngastrat e kontestuar.
44. Në këtë drejtim, Gjykata me rastin e përcaktimit të periudhës kohore që duhet të merret parasysh, do ta marrë fillimin e procedurës, pra muajin korrik 2017, që është data kur parashtruesi i kërkesës paraqiti padi në Gjykatën Themelore si dhe 30 qershorin 2020, kur parashtruesi paraqiti kërkesë në Gjykatë.
45. Prandaj, Gjykata vëren se periudha që duhet marrë parasysh në lidhje me pretendimin e parashtruesit të kërkesës për shkelje të së drejtës për gjykim të drejtë, sipas nenit 31.2 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6.1 të KEDNJ-së, është 4 (katër) vjet e 11 (njëmbëdhjetë) muaj e 26 (njëzetegjatë) ditë.

ii) Parimet relevante

46. Gjykata para së gjithash thekson se, sipas praktikës konsistente të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të rastit, duke marrë parasysh kriteret e vendosura nga jurisprudenca e GJEDNJ-së, dhe në veçanti: (a) ndërlikueshmërinë e rastit; (b) sjelljen e palëve në procedurë; (c) sjelljen e gjykatës kompetente ose autoriteteve të tjera publike; si dhe (d) rëndësinë e asaj çfarë është në rrezik për parashtruesin në kontest (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 7 shkurtit 2002, *Mikulić kundër Kroacisë*, nr. 53176/99, paragrafi 38; Shih gjithashtu rastin e Gjykatës Kushtetuese KI23/16, parashtrues *Qazim Bytyqi dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 majit 2017, paragrafi 58).

iii) Analiza e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procedurës

47. Gjykata vëren se ky rast ka të bëjë me padinë e parashtruesit për vërtetim të kufirit (mezhdës) të palujtshmerisë dhe vërtetim të pronësisë si pjesë e uzurpuar.
48. Përkitazi me ndërlikueshmërinë e rastit, Gjykata i referohet praktikës së GJEDNJ-së që kishte sqaruar se ndërlikueshmëria e rastit mund të ndërlidhet me çështje faktike dhe ligjore por gjithashtu mund të ndërlidhet edhe me përfshirjen e disa palëve në procedurë apo me një numër të caktuar provash që duhet trajtuar para gjykatave të rregullta (shih, *mutatis mutandis*, Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 19 shtatorit 1994, *Katte Klitsche de la Grange*

- kundër Italisë*, Nr. 21/1993/416/495, paragrafi 55; Aktgjykimin e GJEDNJ-së, të 7 shkurtit 2002, *H. kundër Mbretërisë së Bashkuar* nr. 9580/81, paragrafi 72; Aktgjykimin e GJEDNJ-së të 15 tetorit 1999, *Humen kundër Polonisë* nr. 26614/95, paragrafi 63.)
49. Në këtë drejtim, për të konstatuar nëse kohëzgjatja e procedurës ka qenë e arsyeshme, Gjykata duhet të merr parasysh faktorët siç janë: ndërlikueshmeria e rastit, sjellja e parashtruesit të kërkesës si dhe sjellja e autoriteteve relevante gjyqësore. (Shih rastin *Konig kundër Gjermanisë*, GJEDNJ, aplikacioni nr. 6232/73, Aktgjykimi i 28 qershorit 1978, paragrafi 99).
 50. Ndërlikueshmeria e rastit mund të rrjedh, për shembull, nga numri i padive, numri i palëve të përfshira në procedurë, siç janë të pandehurit dhe dëshmitarët apo dhe përmasa ndërkombëtare e rastit (Shih rastin *Neumeister kundër Austrisë*, GJEDNJ, aplikacioni nr. 1936/63, Aktgjykimi i 27 qershorit 1968, paragrafi 20).
 51. Në rastin konkret, Gjykata vëren se rasti i parashtruesit të kërkesës kishte të bënte edhe me palë të tjera. Për pasoj, rasti i tij iu nënshtrua dy palë procedurave, procedurës për shqyrtimin e trashëgimisë mbi pronën e kontestuar sepse në pronën e kontestuar, përveç parashtruesit të kërkesës kishte edhe pronarë të tjerë dhe me pastaj procedurës gjyqësore për vërtetimin e pronësisë.
 52. Gjykata vëren se me 17 maj 2018, parashtruesi i kërkesës kërkoj nga Gjykata Themelore të rifilloj procedurën e ndërprerë përmes Aktvendimit [Cnr. 204/2015] të 27 prillit 2017, me arsyetimin se Gjykata Themelore përmes Aktvendimit [Tc.nr.33/18] të 27 prillit 2018 kishte shpallur tashmë trashigimtarët në pronën e kontestuar.
 53. Gjykata vëren gjithashtu se Gjykata Themelore kishte komunikuar në mënyrë konstante me parashtruesin e kërkesës: (i) duke e njoftuar me statusin aktual të rastit të tij, (ii) duke kërkuara nga parashtruesi i kërkesës që të precizoj padinë dhe të paguaj taksën gjyqësore; (iii) duke vendosur që pala kundërshtarë të ftohet në seancë dhe në fund (iv) duke liruar parashtruesin e kërkesës nga taksa gjyqësore.
 54. Gjykata vëren se shqyrtimi i rastit të parashtruesit të kërkesës në Gjykatën Themelore ishte shoqëruar me vazhdimsi me veprime njoftues dhe procedurale nga ana e Gjykatës Themelore. Në bazë të fakteve të rastit, Gjykata vëren se veprimi i fundit procedural i Gjykatës Themelore në rastin konkret ishte Aktvendimi [C.nr.256/2018] i 28 shtatorit 2020, përmes të cilit parashtruesi i kërkesës u lirua nga taksa gjyqësore.
 55. Në këto rrethana, Gjykata gjen se Gjykata Themelore nuk ka qenë pasive në lidhje me rastin parashtruesit të kërkesës.
 56. Neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6. 1 i Konventës nuk i obligojnë parashtruesit e kërkesave që aktivisht të bashkëpunojnë me autoritetet gjyqësore. Ata, po ashtu, nuk mund të fajësohen për shkak të shfrytëzimit të plotë të mjeteve juridike të vëna në dispozicion nga ligji në fuqi. Megjithatë, sjellja e tyre,

përbën një fakt objektiv që nuk mund t'iu atribuohet autoriteteve publike dhe që duhet marrë parasysh në konstatimin nëse procedurat vazhduan me gjatë se sa afati i arsyeshëm i përcaktuar me nenin 6.1 të Konventës (Shih rastin Eckle kundër Gjermanisë, GJEDNJ, aplikacioni nr. 8130/78, Aktgjykimi i 15 korrikut 1982, paragrafi 82).

57. Neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6. 1 i Konventës obligojnë autoritetet kompetente që ta organizojnë sistemin gjyqësor në atë mënyrë që gjykatat t'i përmbushin të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin në fjalë (Shih rastin Abdoella kundër Holandës, GJEDNJ, aplikacioni nr. 12728/87, Aktgjykimi i 25 nëntorit 1992, paragrafi 24).
58. Edhe pse rastet mund të jenë komplekse, Gjykata, megjithatë, mund t'i konsiderojë si të "arsyeshme" periudhat e gjata të mungesës së aktivitetit gjyqësor. (Shih rastin Adiletta kundër Italisë, aplikacioni nr. 20/1990/211/271- 273, GJEDNJ, Aktgjykim i 24 janarit 1991, paragrafi 17).
59. Në të vërtetë, Gjykata vëren se Gjykata Themelore ishte aktive, nuk kishte qëndruar e heshtur dhe kishte ndërmarrë veprime njoftuese dhe procedurale për rastin e parashtruesit të kërkesës.
60. Gjykata dëshiron të sqarojë se nuk ka njohuri nëse Gjykata Themelore ka nxjerrur apo pritet që të nxjerrë ndonjë vendim në merita lidhur me parashtruesat e parashtruesi të kërkesës.
61. Për më tepër, Gjykata vëren se procedura është akoma në zhvillim e sipër dhe se nuk ka vendim përfundimtar.
62. Gjykata thekson se gjykatat e rregullta kanë parasysh obligimin kushtetues dhe ligjor, që çështjet t'i finalizojnë brenda një afati të arsyeshëm, në mënyrë që të mos shkaktojnë huti dhe pasiguri. Gjykatat e rregullta nuk mund të lejojnë që rasti të bartet pafundësisht prej një instance gjyqësore të tjetra. Përndryshe, besimi i publikut ndaj tërë rendit juridik do të minohet.
63. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se parashtruesi i kërkesës nuk e ka dëshmuar pretendimin se ecuria e procedurës për vendosjen rreth rastit të tij ka rezultuar në tjezgjatje dhe moszgjidhje të rastit brenda një afati të arsyeshëm, e garantuar me nenin 31.2 të Kushtetueses dhe me nenin 6.1 të KEDNJ-së.
64. Prandaj, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës.

PËR KETO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113. 7 të Kushtetutës, me nenin 20 të Ligjit dhe me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 10 shkurt 2021, njëzëri

VENDOS


- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJE këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJE këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtar raportues


Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese


Vjosa Rama-Hajrizi